



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 28 shkurt 2025 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:45.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Zdravko Zdravkoviç (kryesues), Kushtrim Hyseni, Zojë Hajrizi, Behar Duraku, Gresa Muli, Zana Krasniç Saraçi, Berat Maloku, Aziz Emini dhe Adem Hoti, anëtarë të komitetit.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: përfaqësues të KFOR-it slloven, OSBE-së, Aktere Dërvari - përkthyes, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Zdravko Zdravkoviç, kryesues i Komitetit për Komunitete, i cili konstatoi se ekziston shumica për punë.

Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi këtë:

RENDITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025;
3. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025.

Zdravko Zdravkoviç, kryesues i komitetit – ashtu siç jemi pajtuar në mbledhjen e kaluar, ky plan nuk ka ndryshime të mëdha nga ai i vitit të kaluar. Nuk e dimë saktë deri në cilin muaj do të mbajmë mbledhje, sepse këtë vit janë zgjedhjet lokale. Mirëpo, draft-planin e kam përgatitur deri në fund të vitit. Ai e prezantoi para të pranishmëve draft-planin e punës.

Berat Maloku, anëtar i komitetit – ai propozoi që kryetari i komunës të ftohet së bashku me drejtorin e bujqësisë në muajin mars, e jo në muajin qershor. Kështu që, bashkërisht kishim kërkuar një mbështetje më të madhe në sektorin e bujqësisë për komunitetet tona. Në këtë mënyrë, kryetari do të na jepte përgjigje konkrete për çështjen që lidhen me bujqësinë. Pastaj, ne në bazë të mbështetjes së fjalëve të kryetarit, të shkojmë dhe t'i ndihmojmë njerëzve që duan të aplikojnë për grante dhe subvencione në bujqësi.

Shpresoj se nuk do të ndodhë si herën e kaluar që na ka thënë le të aplikojnë, kurse qytetarët nga komunitetet joshumicë kanë aplikuar dhe nuk kanë fituar asgjë.

Zdravko Zdravković, kryesues i komitetit – në muajin mars, pasi do ta ftojme Drejtorinë për Bujqësi, do ta ftojme edhe Kryetarin e komunës.

Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi Planin e Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025.

3. Të ndryshme.

Zdravko Zdravković, kryesues i komitetit – dua të ju njoftojë se Raporti i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024 është aprovuar nga Kuvendi i Komunës. Fatkeqësisht, nuk kam mundur të marrë pjesë në atë mbledhje, por sipas informacioneve që kam marrë është aprovuar pa asnjë diskutim.

Berat Maloku, anëtar i komitetit – pasi që nesër fillon muaji i Ramazanit, shfrytëzoj rastin që t'ua uroj të gjithë besimtarëve të besimit islam. Ai tha se së bashku me shokë të tij organizojnë aktivitete humanitare, duke mbledh ndihma për familjet që kanë nevojë. Andaj, nëse keni informacione se ka familje që janë me gjendje të rëndë ekonomike, më informoni që ta fusim në regjistër.

Ai kërkoi që mbledhja në muajin mars të mbahet nga ora 14:00, për shkak të muajit të Ramazanit.

Të gjithë u pajtuan që mbledhja e muajit mars të mbahet nga ora 14:00.

Zdravko Zdravković, kryesues i komitetit – ju uroj të gjithëve fillimin e muajit të Ramazanit, duke ju dëshiruar shëndet. Njëkohësisht, shfrytëzoj rastin që t'ua uroj Pashkët Katolikë dhe Ortodoksë që janë në muajin tjetër dhe u dëshiroj shëndet.

Mbledhja përfundoi në ora 11:15.

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku
Procesmbajtës

